



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 29, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 5376 Prot., datë 16.10.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

**Lidhur me pyetjen e parë**, mbi strategjinë që po ndjek Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ) për të siguruar uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata, ju informojmë se, është ngritur Grupi i Punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata”, ku përveç anëtarëve të KLGJ-së dhe drejtuesve të gjykatave kryesore, janë ftuar të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Këshilli i Evropës si dhe projekte të tjera të cilat asistojnë KLGJ-në. Strategjia dhe diskutimet e grupit të punës janë fokusuar në:

- a) Vlerësimin dhe analizimin e situatës lidhur me numrin e çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykatat e shkallës së parë administrative dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.
- b) Identifikimin e shkaqeve të krijimit të stokut të çështjeve të prapambetura dhe propozimi i masave konkrete për zgjidhjen dhe adresimin e tij.
- c) Hartimin e një plani veprimi me masa konkrete me synim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura.

Në funksion të veprimtarisë së grupit të punës, janë krijuar katër nëngrupe me përfaqësues nga KLGJ, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykatat e shkallës së parë administrative dhe nga Gjykata Administrative të Apelit, Këshilli i Evropës si dhe nga projektet EWMI/INL dhe EU4 Justice. Këto nëngrupe kanë në fokus të veprimtarisë së tyre:

- i) mbledhjen e të dhënave në funksion të objektivave të përgjithshme të grupit të punës.
- ii) matjen e *backlog*-ut sipas llojit të çështjeve, duke identifikuar shkaqet e vonesave në proceset gjyqësore.
- iii) rishikimin e standardeve të performancës së gjyqtarëve sipas normës së likuidimit.

- iv) zhvillimin dhe paraqitjen e strategjive praktike për uljen dhe parandalimin e *backlog*-ut.
- v) zhvillimin e skenarëve për uljen e *backlog*-ut.
- vi) rishikimin e ndryshimeve në ligjet procedurale dhe aktet e tjera nënligjore si dhe impakti i tyre në uljen e *backlog*-ut.

Grupi i Punës dhe nëngrupet përkatëse vijojnë veprimtarinë e tyre lidhur me analizimin e të dhënave, identifikimin e shkaqeve të *backlog*-ut si dhe adresimin e tyre.

Nga ana e grupit të punës janë miratuar propozime për ndryshime ligjore në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar, të cilat do përcillen së shpejti për kryerjen e veprimeve të mëtejshme. Propozimet për ndryshime ligjore të miratuara nga grupi i punës, kanë si synim ndikimin në uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.

**Lidhur me pyetjen e dytë**, pse vonoi KLGJ-ja për të emëruar 40 magjistratët e rinj që u diplomuan në qershor të këtij viti, ju informojmë se, KLGJ pasi përfundoi të gjitha veprimet procedurale dhe verifikuese të lidhura me proceset e ndryshme të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore nga kandidatët për magjistratë, në datën 18 korrik 2023 vendosi kualifikimin për 40 kandidatë të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023.

Në vijim, në datën 12 tetor 2023, KLGJ vendosi emërimin gjyqtar të 40 kandidatëve diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023 dhe në datën 18 tetor 2023 miratoi vendimin për shpalljen e pozicioneve të lira për gjyqtarët e sapo emëruar.

KLGJ zhvilloi Mbledhjen Plenare në datën 19 tetor 2023, në të cilën vendosi për caktimin në pozicion të 40 gjyqtarëve të emëruar, pra duke përmbyllur me sukses këtë proces. Gjithashtu në datën 20 tetor 2023, në ambientet e KLGJ-së u organizua ceremonia e betimit të 40 gjyqtarëve.

Ndërkohë, KLGJ me përgjegjësinë e mbarëvajtjes së pushtetit gjyqësor, ka ndërmarrë një sërë hapash me qëllim plotësimin e vendeve vakante në gjykata, përmes instrumentit ligjor të lëvizjes paralele, konkretisht nëpërmjet hapjes së procedurave të lëvizjes paralele për disa pozicione në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Durrës dhe Elbasan.

Me qëllim plotësimin e këtyre vakancave, KLGJ vijoi punën intensive për përfundimin e procedurave të transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë të kandidatëve në pozicionet ku kishin kandiduar, në mënyrë që ti hapte rrugë procesit të emërimit të magjistratëve të rinj.

Lidhur me pyetjen, sa gjyqtarë e ushtrojnë efektivisht detyrën në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ju bëjmë me dije se numri sipas strukturës organizative të magjistratëve (gjyqtar) në Gjykatën e Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është 78

gjqtarë, sipas organikës në fakt numri është 32 gjyqtarë dhe efektivisht detyrën e ushtrojnë 22 gjyqtarë.

Lidhur me pyetjen, sa gjyqtarë i janë shtuar trupës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që nga 1 shkurti 2023 që hyri në fuqi harta e re gjyqësore deri më tani, bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore rezultojnë 3 magjistratë (gjqtar) që janë emëruar pranë kësaj gjykate, më konkretisht:

- Me Vendim nr. 583, datë 18.10.2023, është emëruar znj. Marsela Pepi, (efektet e vendimit fillojnë nga data 01.12.2023)
- Me Vendim nr. 585, datë 18.10.2023, është emëruar z. Qemal Zaimi, (efektet e vendimit fillojnë nga data 01.11.2023)
- Me Vendim nr. 634, datë 19.10.2023, është emëruar znj. Alma Kolgjoka, (efektet e vendimit fillojnë nga data 01.11.2023)

**Lidhur me pyetjen e tretë**, mbi akomodimin e Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është vlerësuar se në një zgjidhje afatgjatë nevojitet ndërtimi i një godine të re. Aktualisht stafi i gjykatës së riorganizuar është akomoduar në godinën ekzistuese të ish-Gjykatës së Apelit Tiranë, në kushtet kur numri i gjyqtarëve të apelit aktualisht në detyrë është më i vogël se numri i organikës së miratuar.

Gjithashtu ju informojmë se, në muajin qershor 2022, ish-Gjykatës së Apelit Tiranë, iu akordua një fond në vlerën 2,000,000 lekë, për të realizuar projektin për rikonstruksionin e pjesshëm të ambienteve të godinës ekzistuese, projekt i cili kishte të bënte me përmirësimin e rrjetit kompjuterik dhe elektrik, si dhe rikonstruksionin e bodrumeve të godinës për t'u përshtatur si ambiente arkive. Ndërsa në muajin shtator 2022, kësaj gjykate i është akorduar një fond në shumën 23,800,000 lekë, për të bërë të mundur realizimin e punimeve të zbatimit sipas këtij projekti. Projekti i rikonstruksionit është përfunduar me sukses.

**Lidhur me pyetjen e katërt**, sa është numri i gjyqtarëve të strukturës organizative të secilës gjykatë, sa është numri i gjyqtarëve faktik dhe sa është numri i gjyqtarëve efektivisht në detyrë, ju përcjellim pasqyrën e numrit të magjistratëve (gjqtar) për secilën gjykatë, përditësuar në datë 20 tetor 2023.

<i>Nr.</i>	<i>Gjykata</i>	<i>Struktura organizative</i>	<i>Organika në fakt</i>	<i>Efektivisht në detyrë</i>
1	Gjykata e Lartë	19	19	18
2	Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm	78	32	22
3	Gjykata e Posaçme e Apelit K.K.O	11	10	10
4	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Berat	8	9	4
5	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Dibër	7	4	3
6	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Durrës	23	14	13
7	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Elbasan	18	14	7

8	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Fier	21	18	8
9	Gjykata Shkalla e Parë Juridik.të Përgj. Gjirokastrë	7	7	2
10	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Korçë	15	12	8
11	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Kukës	7	7	4
12	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Lezhë	11	6	2
13	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Sarandë	7	5	3
14	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj. Shkodër	15	12	7
15	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj.Tiranë	80	64	50
16	Gjykata Shkalla e Parë e Juridik.të Përgj.Vlorë	16	13	10
17	Gjykata Posaçme e Shkallës së Parë K.K.O	16	8	9
18	Gjykata Apelit Administrativ	13	8	11
19	Gjykata Administrative Shkalla e Parë Lushnjë	9	8	5
20	Gjykata Administrative Shkalla e Parë Tiranë	27	22	16
	<b>Totali</b>	<b>408</b>	<b>292</b>	<b>212</b>

Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, shprehim gatishmërinë për t’ju përcjellë çdo informacion që ju nevojitet për realizimin e misionit tuaj fisnik për informimin e publikut, në format shkresor. Neni 14§3 i ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, sanksionon se informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik, prandaj informacioni ju përcillet në format shkresor. Mbetemi kurdoherë të gatshëm për të përcjellë çdo informacion shtesë apo shpjegim të nevojshëm në përputhje me ligjin, në funksion të rritjes së transparencës së sistemit gjyqësor dhe informimit të publikut.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!